

**KONTRATE KONÇENSIONI
PER PERDORIMIN E UJIT**

E lidhur sot, me date 21 / 03 / 2007.

NDERMJET

Agjensise se Ujit te Basenit Ujembledhes (Agjensia) "Vjose", Vlore, me Adrese, Lagja: Hajro Cakerri, prane Policise Ushtarake. Perfaqesuar nga Pergjegjesi i Agjensise Z. Vezir METAJ.

DHE

Subjektit juridik (Subjekti) "Uji i Ftohte Tepelene" Sh.p.k ne vijim i quajtur Konçesionari, i regjistruar me Vendimin Nr. 15258, Date 27.06.1996 te gjykates te rrethit Tirane, me seli ne adresen Rruga Nacionale Telene - Gjirokaster perfaqesuar nga administratori Z. Luciano Cirillo.

Per sa me siper Palet bien dakorte si me poshte:

NENI 1

Perkufizime

Sipas kesaj Kontrate, termat e renditura me poshte kane kuptimin si vijon:

Kontrata ose Kontrata e Konçensionit — Kjo Kontrate e hartuar ne mbeshtetje te Ligjit Nr.8093, date 21/03/1996 "Per Rezervat Ujore", i ndryshuar dhe akteve nenligjore ne zbatim te tij.


Sekretariati — Sekretariati Teknik i Keshillit Kombetar i Ujit.

Agjensia — Agjensia e Ujit e Basenit Ujembledhes "Vjose", Vlore.

Konçesionari — Subjekti juridik "Uji i Ftohte Tepelene" sh.p.k, i regjistruar ne Gjykaten e Rrethit Gjyqesor Tirane, me Vendimin Nr. 15258, Date 27.06.1996.

Palet — Kuptohen palet e kesaj Kontrate dhe me termin "Pale" secila prej tyre.

Projekt — Studim tekniko - ekonomik per shfrytezimin e burimit ujqor "Ujet e Ftohte ne Tepelene", i paraqitur dhe i miratuar ne Daten 01/08/2006 nga Keshilli i Basenit Ujembledhes "Vjose", Vlore.



Lejet – Lejet, licencat, autorizimet dhe koncesionet qe Koncesionari mund te kerkoje nga autoritetet kompetente per zbatimin e plote te Projektit si dhe per stafin e vet ne baze te ligjeve ne fuqi ne Republiken e Shqiperise.

Ndryshim thelbesor — Do te thote çdo rrethane ose ndryshim i ligjit, efekti i te ciles eshte diskriminues ndaj:

A) Projektit, ne raport me propozime ose projekte te tjera te paraqitura, te miratuara ose ne zbatim ne Republiken e Shqiperise.

B) Koncesionarit ne raport me subjekte te tjera qe veprojne sipas nje koncesionit te dhene nga Autoritetet e Ujit (K.K.U ose K.B.U) per projekte te tjera te ngjashme.

Force Madhore — Nenkupton çdo ngjarje te jashtezakonshme dhe te paparashikuar si prishje e rendit, lufte, greve ose çdo lloj nderprerje tjeter e punes si dhe çdo ngjarje e barabarte apo e ngjashme me sa me siper, qe mund te ndikoj ne Objektin e kesaj Kontrate, duke bere te pamundur permbushjen e detyrimeve reciproke te Kontrates, qe kane te bejne me vullnetin e paleve dhe eshte jashte kontrollit te mundshem te tyre; katastrofat natyrore si termetet, permbytje, etj si dhe çdo veprim tjeter i forcave natyrore qe do te shkaktonte shterimin e burimit, ne nje shkalle te tille qe do ta bente ate te pa shfrytezueshem.

NENI 2

Objekti i Kontrates te Konçesionit

Kjo Kontrate ka per Objekt dhenien per perdorim me Koncesion, te burimit ujur “Ujet e Ftohet” te ndodhur ne Tepelene, subjektit “Uji i Ftohte Tepelene” Sh.p.k.


Specifikimet e burimit, sipas hartes hidrologjike te vendosjes se burimit dhe te depozituar ne dosjen perkatese, jane:

- Koordinatat e burimit:

x= 4457950 y= 4420250 z= 250.m.

- Sasia mesatare e prurjes: Q = 100 l/sek.

Sasia e ujit qe jepet per perdorim: 5 litra/sek (mesatare vjetore).



Me kërkesen të Konçesionarit, mund të procedohet me rishikimin e sasise së ujit të dhene në përdorim në baze të kësaj Kontrate.

E drejta për shfrytëzimin e këtij burimi i është dhënë Konçesionarit mbi bazën e Vendimit Nr. 1, Datë 04.12.2006 të Këshillit të Basenit Ujëmbledhës Vjose, Vlorë. Ky vendim do të zbatohet sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara në këtë Kontratë.

NENI 3

E drejta e pronësise

Pronësia mbi burimin ujor, "Uji i Ftohtë" në Tepelene i takon shtetit dhe regjimi (mbi bazë koncesioni) me të cilin ai jepet në përdorim regjistrohet në regjistrin e koncesioneve për përdorim uji.

NENI 4

Qëllimi i përdorimit dhe destinacioni

Burimi ujor do të përdoret, me qëllim konfeksionim uji mineral natyral dhe/ose të produkteve të tjera jo alkolike.

NENI 5

Afati i Kontrates të Konçesionit


- Kjo Kontratë Konçesioni lidhet për një afat 30 (tridhjetë) vjet duke filluar që nga dita që kjo Kontratë do të bëhet efektive midis palëve.
- Përfundimi i Kontrates mund të shtyhet në rast se verifikohen kushtet e parashikuara nga neni 19 i ligjit nr. 8093 datë 21.03.1996 "Për rezervat ujore" i ndryshuar.

NENI 6

Të Drejtat dhe Detyrimet e Konçesionarit

- Konçesionari ka të drejta ekskluzive (për sasinë e ujit 5 l/sek që do të përdoret) të kryej veprimtari, në bazë koncesioni, sipas kushteve të përcaktuara në këtë Kontratë.

- Konçesionari do të kryej pagesat për:



a) Tarifat ne lidhje me perdorimin e ujit me koncesion.

- Tarifat do te llogariten per m³ ne baze te sasise faktike te perdorur, te matur me matesat e ujit (kontaktoreve) te vendosur para hyrjes ne stabiliment.

- Detyrimi i Konçesionarit per pagimin e tarifes te perdorimit te ujit fillon qe nga momenti i instalimit te matesave te cilet do te sherbejne per matjen e sasise se ujit qe do te perdoret sipas kesaj Kontrate.

- Pagesat per tarifat e ujit te perdorur do te behen pas inspektimit ne vend, nga Perfaqesuesit e Sekretariatit ose Agjensise, te matesave te ujit ku do te perpilohet Proces-Verbali perkates per sasine e ujit te perdorur.

- Gjate zbatimit te Kontrates se Koncesionit, inspektimi nga perfaqesuesit e Sekretariatit ose Agjensise, do te behet çdo 30 (tridhjete) dite.

- Tarifat e perdorimit te ujit me koncesion, te percaktuara nga Vendimi Nr. 313, date 21/05/2004 te Keshillit te Ministrave, do te kryhen nga Koncesionari ne Nr e llogarise 0102030780 te Ministrise te Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujrave, dega e thesarit Tirane.

Pagesa do te kryhet brenda 30 (tridhjete) diteve nga paraqitja e fatures tatimore perkatese ose dokumenti tjetër i cili njihet si i vlefshem nga ana e Drejtorise se Pergjithshme te Tatimeve.

- Detyrimi i Koncesionarit per te paguar tarifën, mbaron ne rast se Kontrata e Koncesionit humbet vlefshmerine midis Paleve, per çfaredolloj arsyeje.

- Koncesionari angazhohet te veproje ne perputhje me legjislacionin ne fuqi dhe ne veçanti:

- Te respektoj te gjitha legjislacionin shqiptar ne fushen e veprimtarise se shoqerive tregtare.

- Te respektoj qellimin dhe menyren e perdorimit te ujit te percaktuar ne nenin 4 te kesaj Kontrate, duke mos i ndryshuar ato.


- Te perdore ujin ne perputhje me percaktimet e nenit 4 me siper.

- Te marre masa per mbrojtjen e brigjeve te burimit ujqor.

- Te respektoj masat mbrojtese sipas kushteve dhe kerkesave higjeno-

sanitare per evitimin e ndotjeve, masat mbrojtese per mjedisin dhe te ruaj te pandryshuar cilesine e ujit dhe te burimit.

- Te mos kryej veprime apo mosveprime qe sjellin drejtperdrejte ose si pasoje



ndryshimin e formes, gjendjes dhe te kufijve te burimit.

- Te perballoje te gjitha shpenzimet per rrethimin dhe mirembajtjen e burimit te cilat jane mbajtja e paster e pikes se dalje se ujit dhe heqja e mbetjeve natyrale te mundshme qe mund te grumbullohen per shkaqe natyrore.

- Te marre te gjitha masat praprake, me qellim qe te garantoj jeten e punetoreve dhe te te treteve, te shmang demet ndaj prones publike dhe private, te respektoj te gjitha format ne fuqi dhe dispozitat e karakterit te pergjithshem teknik per te parandaluar çdo dem dhe fatkeqesi ne pune.

- Te zbatoje dhe te beje qe te zbatohen te gjitha dispozitat ne fushen e punes, sigurimeve shoqerore dhe shendetesore te parashikuara nga Legjislacioni shqiptar.

- Te mos ia kaloje apo te transferoje te drejten e perdorimit te ujit te treteve, me perjashtim te rasteve kur autoriteti i ujit, me shkrese i'a njeh te drejten e transferimit per perdorimin e ujit nje personi te trete, i cili do te lidhe kontrate me autoritetin e ujit qe eshte pale ne kete Kontrate Konçesioni.

- Te mos pengoje Sekretariatit ose Agjensine, te ushtroje te drejten e kontrollit.

- Pas mbarimit te afatit te perdorimit, ta kthej burimin uJOR ne te njejten gjendjen qe e ka marre ne dorezim (duke llogaritur nje amortizim apo konsumim te burimit uJOR, si rezultat i perdorimit normal dhe te perditshem te tij nen prezencen e kushteve atmosferike karakteristike per vendndodhjen e burimit).

- Te perjashtoje nga çdo lloj pergjegjesie te Sekretariatit ose Agjensise, per sa parashikohet ne kete nen per demet, demtimet dhe te tjera qe mund ti ndodhin Konçesionarit dhe stafit te vete gjate periudhes te konçesionit.

- Te perballoje me te gjitha shpenzimet, çdo shperblim per deme shkaktuar te treteve nga perdorim jo i duhur i burimit nga ana e Konçesionarit.

- Te permbush detyrimet e percaktuara ne kete Kontrate.

-Vendosja e matesave te ujit eshte ne ngarkim te Konçesionarit i cili gjithashtu ne daten e inspektimit nga Sekretariati ose Agjensia, duhet te kryej edhe instalimet e nevojshme ne prezence te perfaqesueseve te Sekretariatit ose Agjensise, por ne çdo rast brenda dates 29 Mars 2007. Shpenzimet per blerjen dhe instalimet e matesave te ujit do te perballohen nga Konçesionari.



NENI 7

Te drejtat dhe detyrimet e Sekretariatit ose Agjensise

- T'i garantoje Koncesionarit ekskluzivitetin, e perdorimit te burimit sipas qellimit dhe destinimit te percaktuar ne nenin 4 te siperpermendur.
- Te vere ne dispozicion te Koncesionarit, burimin uJOR ne gjendjen ne te cilen ndodhet.
- Te mos beje asnje Ndryshim Thelbesor.
- Ka te drejte dhe detyre te kontrolloje rregullisht ecurine e Kontrates te Koncesionarit sipas kushteve te miratuara ne te.
- Te ruaj ligjerisht pronesine mbi mjetet kryesore te koncesionit, i cili eshte burimi.
- Te mos lejoje nderhyrje apo punime ne zonat mbi ose perreth burimit te cilat mund te kompromentojne ne çdo lloj menyre perdorimin e rregullt te burimit, nga ana e Koncesionarit, dhe/ose modifikojne parametrat cilesore dhe sasiore te ujit .

Per percaktimin e ketye zonave i behet referim studimit urbanistik bashkengjitur kesaj kontrate.

NENI 8


Zgjidhja e Kontrates te Koncesionit

Palet mund te zgjidhin kete Kontrate Koncesioni ne rastet kur konstatojne shkelje te renda dhe te vazhdueshme te detyrimeve te parashikuara ne kete kontrate te kryera nga Pala tjetere, te cilat kompromentojne rende afatet dhe kushtet e percaktuara ne Projekt.

Pala e demtuar duhet t'ia beje te njohur menjehere pas konstatimit, keto shkelje Pales tjetere. Nese brenda 30 diteve nga njoftimi kjo e fundit nuk kryen riparimin e shkeljes se njoftuar Pala e demtuar mund te kerkoj ose jo zgjidhjen e Kontrates se Koncesionit sipas procedures te percaktuar ne nenin 16 te kesaj Kontrate.

Mbetet ne fuqi e drejta e demshperblimit te demeve, direkte dhe indirekte si rrjedhoje e zgjidhjes se Kontrates, per shkak te mospermbushjes te ndodhur.

Zgjidhja e Kontrates do te behet ne rastet kur Koncesionari eshte deklaruar i falimentuar, i pa afte per pagimin e tarifes per perdorimin e buimit uJOR ose kur eshte ne likujdim.



NENI 9
Sigurimet dhe mbulimet e demeve te shkaktuar burimit

Koncesionari do te kryeje nje mbulim me sigurim te demeve qe i ndodhin burimit per shkak te sjelljes dhe/ose neglizhences se rende se tij.

Koncesionari do t'i jape Sekretariatit dhe Agjensise, me kerkesen e kesaj te fundit te gjithë dokumentacionin e nevojshem qe ka te beje me llojet e sigurimeve te bera.

Ne rast se objekti i siguruar do te demtohet ose shkaterrohet per faj te Koncesionarit, dhe shoqeria siguruese do kryeje pagesen sipas polices se sigurimit, te ardhurat e marra do te perdoren per riparimin e burimit.

NENI 10
Riparimi dhe Mirembajtja

Gjate periudhes se koncesionit, Koncesionari do te kryej me shpenzimet e veta mirembajtjes e zakonshme te burimit .

NENI 11
Kontrolli dhe inspektimet


Sekretariati ose Agjensia, ka te drejte te kontrolloje rregullisht burimin gjate periudhes se kohezgjatjes se kesaj Kontrate.

Koncesionari dhe Sekretariati ose Agjensia do te rakordojne rast pas rasti per menyren dhe kohen e ketyre inspektimeve duke mbrojtur gjithmone kerkesat e prodhimit dhe aktivitetin e Koncesionarit.

Sekretariati ose Agjensia, e realizon kontrollin nepermjet te autorizuarëve te tij sipas afateve dhe menyrave te rena dakort me Koncesionarin.

Koncesionari, me kerkese me shkrim nga ana e sekretariatit ose Agjensise, duhet te jape te gjitha sqarimet teknike te nevojshme.

Te gjitha shkeljet e konstatuara nga Sekretariati ose Agjensia, gjate kontrollit te pergjithshem, do t'i njoftohen me shkrim Koncesionarit sipas procedures te parashikuar nga neni 8, paragrafi i dyte.)



NENI 12
Legjislacioni i zbatueshem

Interpretimi dhe zbatimi i kesaj kontrate Koncesioni do te bazohet ne legjislacionin shqiptar ne fuqi.

NENI 13
Forca Madhore

Palet nuk mund te jene pergjegjese ne rast mospermbushjeje te detyrimeve te tyre te parashikuara ne kjo Kontrate si pasoje e ndodhjes te njeres prej ngjarjeve te Forces Madhore, ne rastin kur Pala e demtuar i ka mane te gjitha masat e nevojshme per te permbushur detyrimet e veta.


Ne rast se nje detyrim i parashikuar ne kete Kontrate vonohet ose behet i pamundur si rezultat i Forces Madhore, Pala e demtuar eshte e detyruar te njoftoj me shkrim Palen tjeter, duke i treguar dhe arsyetuar motivet e voneses ose te pamundesise si dhe masat e marra per te parandaluar dhe evituar pasojat.

Periudha e nderprerjes dhe shtyrja e afateve te parashikuara per permbushjen e detyrimeve perkatese do te konfirmohen nga Palet ne nje Proces-Verbal per ngjarjen. Si rrjedhim i ngjarjeve te shkaktuara nga nje Force Madhore, periudha e Koncesionit do te shtyhet automatikisht per nje periudhe te barabarte me periudhen e nderprerjes si shkak i forces madhore .

NENI 14
Hyrja ne Fuqi

Kjo Kontrate do te hyje ne fuqi me plotesimin e kushteve te meposhtme:

- a) nenshkrimi i kesaj Kontrate prej Paleve, ndermjet Agjensise dhe Koncesionarit.
- b) miratimi i kesaj Kontrate nga Keshilli i Basenit Ujembledhes Vjose, Vlore.



NENI 15
Zgjidhja e Mosmarreveshjeve

Problemet ose mosmarreveshjet e krijuara midis Paleve, ne lidhje me zbatimin dhe interpretimin e kesaj Kontrate, nuk do te nderpresin apo anullojne detyrimet e Paleve sipas kesaj Kontrate.

Palet marrin persiper ne parim, te zgjidhin me mirekuptim cdo lloj mosmarreveshje.

Ne te kundert, per cdo mosmarreveshje qe lidhet me kete Kontrate si shkeljet, anullimi ose pavleshmeria e saj, Palet kane te drejte t'i drejtohen Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tepelene.

NENI 16
Sanksionet

- Ne rast se brenda 15 diteve, nga data e inspektimit nga Sekretariati ose Agjensia, Koncesionari nuk paguan tarifen e perdorimit te ujit, per cdo dite vonese do te aplikohet nje penalitetet i barabarte me 5 mije leke ne dite prej nje afati 1-mujor. Me kalimin e ketij afati, Agjensia mund te zgjidh Kontraten e Koncesionit ne baze te nenit 8 me siper.

NENI 17
Dispozita te Pergjitheshme

Kjo Kontrate eshte hartuar ne gjuhen shqipe.

Kjo Kontrate eshte hartuar dhe nenshkruar ne 4 (kater) origjinale, 3 (tre) prej te cilave mbahen nga Agjensia Vjose dhe nje nga Koncesionari.

